

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E KAMENICËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	653-25-8696-5-2-1
Nr i brendshëm	KM653-25-072-5-2-1

Sa i përket tenderit për

Ndërtimi i transformatorit me SN-400KvA

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Risamont SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Brahim Ademi, Bregu i Diellit

(Adresa)

Prishtinë

10 000

(Vendi)

(Kodi postar)

+38349393528

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Riad Rexhepi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

risamont@gmail.com

(Adresa elektronike)

08.12.2025

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 23.09.2025
Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 15.10.2025
Njoftimi i Vendimit të AK: 20.11.2025
Vendimi në KRSH: 27.11.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 51 i LPP-së
Neni 53 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 65-71 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së

** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me date: 20.11.2025 kemi pranuar Vendimin e Autoritetit Kontraktues, nga ku ne si OE i pergjegjshem jemi eliminuar nga AK me pretendimet e meposhtme:

*'Tek pajisjet e dorezuara jane ne kundershtim me kerkesat e AK.
Pajisja kamion me kipere shte me regjistrim te skaduar.
Austoshporta e dorezuar eshte me regjistrim te skaduar.
Gjithashtu edhe kamioni me kran eshte me regjistrim te skaduar.
Per menaxherin e projektit mungon licenca gjithashtu edhe per Ing te ndertimit mungon licenca.'*

Me date: 21.11.2025 kemi kerkuar qasje ne dokumente, ku edhe na jane derguar dokumentet e OE te propozuar per kontrate.

Pasi qe kemi analizuar te gjitha dokumentet e pranuar, ateher kemi ardhë deri te perfundimet te cilat po i elebrojme meposhte.

Te gjeturat:

Sipas kerkesave te AK te specifikuara ne FDT, respektivisht:

*Kerkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale
Kapaciteti teknik dhe professional:*

Pretendimi i pare:

Kërkesa .2. Stafin profesional si vijon

a)Një Menaxher i projektit-Inxhinier i diplomuar i Elektros-Drejtimi elektroenergjetikë me 5 vite përvojë pune pas diplomimit.

b)Një Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit

c)Një Gjeodet Bachelor apo master i diplomuar dhe i licencuar minimum 3 vjet përvojë pune pas diplomimit.

- Min 10 puntorë.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia.2.Lista e stafit të angazhuar në këtë projekt e nënshkruar dhe vulosur ,për pikat a.b dhe c kërkojnë Licencat për pikat a dhe b,Diploma kopje, Kontrata ose parakontrata me ofertuesin si dhe cv-ja nënshkruar.

Për 10 punëtorët kontratat ose parakontratat me ofertuesin.

Deshmi dokumentare:

Sipas Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësujë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Duke ju referuar Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, si dhe mare parasysh se oferta jone ka çmimin me te lire nga te gjithë OE pjesmarres, me theks te veçant nga **OE i propozuar per kontrate per vleren: 4.314,70€**, ateher AK ka qene e detyruar te aplikoj Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe te sqaroj te gjitha pyetjet per tu scaruar konform Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, prandaj pretendimet e AK per keto pika jane te pa bazuara.

Neve i kemi Licencat perkatese dhe te njejtat po ju dergojme si deshmi dokumentare. Lista e stafit e dorezuar me oferte nuk ka qene e perditesuar me te gjitha dokumentet e kerkuara konform kerkesave te sepcifikuara ne FDT, prandaj edhe ka ndodhe nje leshim teknik,

mirepo konform *Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë*, nje situatë e tillë duhet të scarohet, prandaj:

Ne kete rast AK ka vepruar ndesh me *Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë*

Pretendimi i dyte:

Kërkesa-3-

Lista e mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit sipas specifikimit teknik në dosje të tenderit tek Aneksi 7.

Dëshmia-3.

Pajisjet që regjistrojnë duhet të vërtetohen me librezë regjistrimi (pajisjet duhet të jenë të regjistruara), ndërsa pajisjet e tjera, OE duhet ta vërtetojë me dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD, etj.), në rast marrëveshjeje. për të marrë në shfrytëzim, marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me vlefshmëri që nga kohëzgjatja e kësaj kontrate të nënshkruar dhe e vulosur nga të dyja palët.

Deshmi dokumentare:

Sipas *Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë*

Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Duke ju referuar *Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë*, si dhe mare parasyshe se oferta jone ka çmimin me te lire nga te gjithë OE pjesmarres, me theks te veçant nga **OE i propozuar per kontrate per vleren: 4.314,70€**, atëher AK ka qene e detyruar te aplikoj *Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë* dhe te sqaroj te gjitha pyetjet per tu scaruar konform *Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë*, prandaj pretendimet e AK per keto pika jane te pa bazuara.

Neve i kemi Librezat perkatese me afat te regjistrimit pa shkeputje nga regjistrimi paraprak dhe te njejtat po ju dergojme si deshmi dokumentare. Lista e pajisjeve e dorezuar me oferte nuk ka qene e perditesuar me te dhenat e fundit, prandaj edhe ka ndodhe nje leshim teknik, mirepo konform *Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë*, nje situatë e tillë duhet të scarohet, prandaj:

Ne kete rast AK ka vepruar ndesh me *Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë*

Me kete rast AK ka vepruar ndesh me te gjitha nenet e listuara ne 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues, me theks te veçant :

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Me date: 27.11.2025 kemi pranuar Vendimi e AK kundrejt Kerkeses per Rishqyrtim te ushtruar brenda afateve kohore me date: 24.11.2025, ku AK e ka refuzuar ne plotni kerkesen per rishqyrtim, duke pretenduar se ndeshet me ndryshime materiale te dosjes se tenderit, gje qe kjo nuk eshte e vertet, pasi qe neve me kerkesen per rishqyrtim per makinerine e njejte kemi dorezuar librezat me regjistrim me afat dhe pa shkeputje nga regjistrimi paraprak.

Pretendimet e AK se pajisja:

Pajisja kamion me kipere shte me regjistrim te skaduar. E kerkuar nje cope

Neve me liste te pajisjeve kemi dorezuar dy kamion kiper njeri nga te cilet e ka te dorezuar librezen me afat regjistrimi 14.10.2026, gje qe pretendimet e AK se kjo pike nuk eshte plotesuar nuk qendron, pasi qe kerkesa ka qene per nje cope.

Ndersa per kamionin tjetër kiper ne Kerkesen per Rishqyrtim e kemi bashkangjitur librezen me afat te regjistrimit pa shkeputje nga regjistrimi paraprak.

Gjithashtu per Inxhinieret kemi dorezuar Licencat ku Vendimet per Licencime jane para dates se dorezimit te tenderit.

Ne kete rast AK ka vepruar ndesh me **Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë**

Me kete rast AK ka vepruar ndesh me te gjitha nenet e listuara ne **6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**, me theks te veçant :

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndaloher që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasi të artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

5. Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare,

parametrat e saktë të një kërkesë të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.

6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë;

(i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit;

(ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj;

(iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik;

(iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përzgjedhjes dhe dhënies të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit;

(v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.

Njëkohësisht AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, ku edhe pse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.*

Ndërsa pika (vi) e paragrafit 6 e nenit 7 të LPP-së e përcakton qartë që *“që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse.*

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar Ankesa e OE Risamont SH.P.K.
Te anulohet Vendimi i AK dhe procesi te kthehet ne rivleresim.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kostot e tilla do te llogariten ne fazat vijuese.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*